3. Promovimi i integrimit kulturor dhe ruajtja e identitetit kombëtar	1. Organizimi i aktivitetave kulturore dhe artistike për ruajtjen e identitetit kulturor në diasporë (koncerte, eksposita, punëtori).	10 aktivitete kulturore pjesëmarrje te diasporës për secilin aktivitet.	Korrik - Gusht 2025	€20,000.00	Drejtoria e Diaspores donacione	Drejtoria e Diasporës, Ministria e Kulturës	Pjesëmarrësit mund të përfshijnë artistë të njoftur nga diaspora dhe Kosova.
	2. Krijimi i një platforme online për mësimin e gjuhës shqipe për diasporën.	Platforma e funksionalizu ar me 1,000 përdorues aktivë brenda viti.	Janar - Dhjetor 2025	€20,000.00	Donacione të BE-së, partnerë ndërkombëtarë	Drejtoria e Diaspores, Ministria e Arsimit, IT	Nevojitet një ekip për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e platformës.
	3. Përcaktimi i ditëve kulturore të Vushtrrise në qytete të rëndësishme ku jeton diaspora.	3 ditë të kulturës së Kosovës të mbajtura në qytete kryesore (Gjermani, Skandinavi, ShBA).	Janar– Nëntor 2025	€30,000.00	Buxheti komunal, donacione	Drejtoria e Diasporës, Ambasada t	Aktivitetet mund të përfshijnë ambasadat dhe komunitetet lokale.

	4. Organizimi i një konkursi për ekspozita të realizuar nga të rinjtë e diasporës për promovimin e identitetit kombëtar.	50 picture të dorëzuar dhe 5 të shpërblyer.	Gusht 2025	€10,000.00	Donacione, bashkëpunim me fondacione kulturore	Drejtoria e Diasporës,	
4. Lehtësimi i shkëmbimeve arsimore dhe profesionale mes Vushtrrise dhe diasporës	1. Krijimi i programeve të shkëmbimit arsimor për studentët e diasporës që duan të studiojnë në Kosovë ose të marrin pjesë në projekte kërkimore.	100 studentë të diasporës të përfshirë në programe shkëmbimi arsimor brenda vitit.	Shtator 2025	€80,00	Donacione, fonde nga BE-ja, fondet shtetërore	Ministria e Arsimit, Drejtoria e Diasporës	Mund të përfshihen partneritet e me universitet e ndërkombëtare dhe lokale.

Shëndetësia dhe Përkuqdesja Sociale

Aktivitetet e planifikuara	Koha dhe vendi I implementimit të aktiviteteve	Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve
1. Shërbimet shëndetësore			
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore	Janar- Dhjetor 2025	<p>Qasje e lehtë e pacientëve në institucionet e kujdesit parësor</p> <p>Shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore në të gjitha institucionet e kujdesit parësor</p>	Këshillit Drejtues, Drejtoria e QKMF-së Komisioni Disiplinor Kryeinfermierja
2. Zbatimi i ngritjes së përgjegjësisë në punë			
	Janar- Dhjetor 2025	<p>Respektimi i orarit të punës</p> <p>Respektimi i orarit të pauzës gjatë orarit të punës</p>	

Ngritja e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë			Këshillit Drejtues, Drejtoria e QKMF-së Komisioni Disiplinor Kryeinfermierja
3. Ngritja e vazhdueshme e nivelit cilësor dhe ofrimi I shërbimeve shëndetësore			
Ngritja e vazhdueshme e nivelit cilësor dhe sasior të shërbimeve shëndetësore	Janar- Dhjetor 2025	<p>Trajnimi i stafit infermier or</p> <p>Trajnimi i stafit jo infermier or</p> <p>Trajnimi do të organizohet në koordinim me personelin në dispozicion nga QKMF dhe organizatat të tjera</p> <p>Trajnimet miratohen dhe koordinohen nga kryeinfermierja e QKMF-së me qëllim te plotësimit të nevojave te QKMF-së</p>	Drejtoria Kryeinfermierja Organizatat ZHVP

SHËNDETI PUBLIK

Sektori i shëndetit publik është në kuadër të Departamentit të Mjekësisë Familjare i cili funksionin e vete e ushtron duke u bazuar ne

- Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative
- Ligjin për Shëndetësi,
- Udhëzimin Administrativ për KPSH
- Statutin e Komunës dhe
- Statutin e Qendrës Kryesore te Mjekësisë Familjare

Sektori për Shëndet Publik ne kuadër te Departamentit te Mjekësisë Familjare, duke u bazuar në planin e punës për vitin 2025, do të kryen këto veprimtari:

1. Shërbimet e promovimit shëndetësor duke përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin;
2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese
3. Shërbimi i imunizimit për punëtorët shëndetësor kundër hepatitit B te grupet që janë kategori e rezikuar për tu infektuar me hepatitin B .
4. Zbatimin e sistemit unik të informimit shëndetësor në QKMF ,QMF dhe AMF.

OBJEKTIVAT KRYESORE TE SEKTORIT TE SHËNDESTIT PUBLIK

Mbrojtja parandaluese nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit, edukimit shëndetësor, edukimit mbi sëmundjen dhe vizitave sistematike të fëmijëve parashkollar dhe të nxënësve të klasave të para, të pesta dhe të nënta, në Shkollat Fillore të Komunës(me qellim të zbulimit të hershëm të sëmundjeve të ndryshme siç janë: anomalitë kongjenitale,(ngecjet trupore, mendore, shqisore, deformitetet e lindura), zbulimi i hershëm i kariesit,sëmundjeve ngjitëse(pedikuloza, skabiesi etj.) (Realizimi i vizitave sistematike të nxënësve të shkollave fillore për klasat e para ,të pesta dhe të nënta do të fillon në muajin janar 2025). Promovimi shëndetësor për të rinjtë me qellim të ngritisës së edukatës shëndetësore në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse seksualisht të transmetueshme siç janë:(gonorea, sifilizi, HIV-AIDS), pengimi i shtatëzanësisë së padëshirueshme, kontracepsioni, parandalimi i dukurive negative: alkoolizmi, narkomania, prostitucioni, delikuanca e të tjera , nëpërmes ligjëratave, fletëpalosjeve, mjeteve të shkuara elektronike e të tjera.

II. Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik, përfshirë sero profilaksinë, vaksino profilaksinë (imunizimi i fëmijëve me qellim të parandalimit të sëmundjeve ngjitime) dhe kimio -profilaksinë në pajtim me ligjin si dhe arsimimin dhe edukimin sistematik shëndetësor të popullatës.

- a) Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit për shëndetin e dhëmbëve
- b) Diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi i tuberkulozes .
- c) Promovimin e ushqimit të shëndetshëm.
- d) Zbatimi i sistemit unik të informimit shëndetësor ,siç është paraparë me ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë lëmë.

N r.	Objektivat	Realizimi objektivave	I	Planifikimi realizimit	I	Vërejtje
1.	Avancimi i punës në njësinë e SISHI-it. Analiza e të dhënave,sistematisizimi dhe raportimi I rregullt I sëmundjeve (Raportimi i të dhënave Statistikore Shëndetësore sipas UA(Shëndetësi) Nr. 11/2013 Sistemi i Informatave Shëndetësore dhe raportimi i të dhënave Statistikore Shëndetësore. Mirëmbajtja e Sistemit Shëndetësor për Zero Klient. Moduli (BHIS+Moduli i Vaksinimit ,Moduli EPPV,Moduli i Vizitave për	Mjekët Infermierët Operatorët Drejtoria e QKMF-së dhe DSHMS.		Në kontinuitet		Raportimi mujor në IKSHPK përmes kopjimit të bazës së të dhënave nga SISH-i

	nëna shtatzëna dhe fëmijë në Shtëpi , Moduli i SMSN). Mirëmbajta e Serverit, Mirëmbajta Bazës së të dhënave, Menaxhimin i backup-it, Menaxhimin dhe azhurimin e raporteve , Mirëmbajta softuerike e Serverit. Shtrirja e rrjetit në QMF, AMF në nivel Komune. Mbajtja e trajnimit të stafit.			
2.	Hartimi I planit të imunizimit duke u bazuar në Planin e Zgjeruar të imunizimit dhe zbatimi I programit të imunizimit nën mbikëqyrjen dhe vlerësimin e IKSHPK-së	Njësia e imunizimit dhe vaksinimit	Në kontinuitet	
3.	Vazhdimi I programit të implementimit të kujdesit antenatal dhe prenatal nga këshillimorja e Qendrës së Mjekësisë Familjare	QKMF	Në kontinuitet	Plani është në përputhshmëri me politikat e MSH.
4.	Implementimi I projektit për përmirësimin e qasjes ndaj shërbimeve të planifikimit të familjes dhe shëndetit riprodhues	QKMF QMF AMF	Gjatë vitit	

5.	Edukimi I pacientëve I fokusuar në sëmundje kronike ,sëmundje infektive, shëndet reproduktiv, fëmijët deri në moshën 5 vjeçare, kujdes paliativ (pacientët me nevoja speciale) , shëndetin mendor etj.	QKMF, QMF, Infermierët për Edukim Shëndetësor	Gjatë vitit	Raportet e obliguara mujore në lidhje me punën në komunitet nga secila QKMF, QMF dhe AMF.
6.	1.Edukimi shëndetësor I nxënëseve të shkollave fillore për higjenën personale dhe orale. 2. Vizita sistematike e të gjithë nxënësve të klasave të para, të klasave të pesta dhe të klasave të nënta në të gjitha Shkollat Fillore ta Komunës.	QKMF, infermierët për edukim shëndetësor,QRS HP. Ekipi shëndetësor : spec. të MF, stomatolog, infermier, laborant, psikolog,administrator,operator.	1.Gjatë vitit 2.Nga muaji Janar deri në muajin Maj 2025.	Bashkëpunimi me drejtoret dhe mësimdhënësit në shkolla me qellim të ngritjes të higjenës personale të nxënësve. Kjo do të realizohet nëse ekzistojnë mundësítë financiare. Projekti do të zbatohet në bashkëpunim me DKSH dhe MS, DKA dhe Drejtoren e QKMF-së
7.	Edukimi I të rinjëve neper shkolla I orientuar në tema mbi disa dukuri negative në shoqëri me të cilat ballafaqohet rinia si: abuzimi I drogave,alkoolizmi,pirja e duhanit, prostitucioni, delikuencia, shtatzënitë e padëshirueshme,,kontracepcioni,sëmundjet seksualisht të	QKMF, infermierët për edukim shëndetësor,QRS HP.	Gjatë vitit.	Hulumtimi i donatorëve të ndryshëm për realizimin e projekteve në shkolla me qellim të furnizimit me material edukativ(fletushka,revista) etj.

	transmetueshme: gonoreja, sifilisi,HIV-AIDS etj.			
8.	Edukimi në komunitet përmes radios, TV-së ,fletëpalosjeve,sidomos në shënimin e ditës ndërkombe tare të sëmundjeve të ndryshme,TBC-së,HIV-AIDS,kundër kancerit, pirjes së duhanit etj.	Infermierët e edukimit shëndetësor	Gjatë vitit	Bashkëpunimi me QRSHP
9.	Edukimi shtesë I populatës në rast të paraqitjes së epidemive (edukimi për parandalim të Tularemisë , Parotitit epidemik, Gripit , Hepatitit infektiv dhe inokulativ(Hepatiti A, B, C, fruthit, brucelozës dhe sëmundjeve tjera sipas indikacioneve epidemiologjike në teren)	QKMF,	Gjatë vitit	Involvimi i të gjitha strukturave udhëheqëse shëndetësore dhe institucioneve shëndetësore; QRSHP, IKSHP, e të tjera.

Vaksinimi nëpër shkolla dhe institucione tjera	Janar –Dhjetor 2025	Me vaksinim nëpër shkolla të arrijmë parandalimin e shumë sëmundjeve tek fëmijët dhe nxënësit	Drejtoria e QKMF-së ,Shefja e Shëndetit Publik ,Kryeinfermierja dhe përgjegjësja e vaksinimit .
--	---------------------	---	---

Planifikimi i pushimeve vjetore	Janar –Dhjetor 2025	Do ta bëjmë planifikimin e pushimeve vjetore në fillim të vitit	Drejtoria e QKMF-së ,Shefja e Shëndetit Publik ,Kryeinfermierja dhe përgjegjësja e vaksinimit .
---------------------------------	---------------------	---	---

Do paraqesim ne forme tabelare planifikimin

Nr	Emri	Të planifikuar	
1	Fëmijët 0-11 muaj	710	
2	Fëmijët 12-24 muaj	712	
3	Kl.I	941	
4	Kl.VI	955	
5	Maturantët	673	
6	Vaksinat e gripit	1800	

KUJDESI PËR NËNA DHE FËMIJË

Klasa për Nëna është pjesë e programeve edukative për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Këto klasa ofrojnë shërbime edukative shëndetësore për vajzat, gratë si dhe partnerët e tyre duke përfshirë midis tjerash: përgatitjen për një shtatzëni të shëndetshme, ecurinë e saj dhe procesin e lindjes, kujdesin ndaj foshnjës, rëndësinë e të ushqyerit me gjë, përgatitjen psikike dhe fizike për sallën e lindjes, si dhe informacione të tjera për kujdesin dhe zhvillimin e fëmijës.

MËNYRA E FUNKSIONIMIT SË KLASAVE PËR NËNA

KN organizohet brenda ambientit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë familjare. Nënët, shtatzënati, ciftet, vajzat mund të marrin pjesë. Infermieret e trajnuara janë të obiguara të organizojnë sesione në kuadër të shërbimit KN.

Temat të cilat mund të ligjerohen varësisht prej kërkesës dhe nevojës së pjesëmarrëses/ve janë këto:

- Shtatzania e shëndetshme
- Ushqyerja në shtatzani
- Si e kuptoni se ju jeni shtatzënë
- Aktivitetet fizike gjatë shtatzanisë
- Shtatzënia dhe rrezitja
- Shëndeti oral
- Përgatitja e procesit të lindjes
- Depresioni pas lindjes
- Teknikat e lindjes
- Shtatzënia dhe stresi
- Hekuri
- Problemet me gjumin
- Kujdesi pas lindjes
- Ditët e para me të porsalindurin
- Si e planifikoni pushimin e lehonisë
- Të qenit i shëndetshëm dhe i sigurt në punë
- Ushqyerja e fëmijëve
- Foshnja dhe kujdesi amënor
- Gjidhënia
- Shtatzënia
- Lindja
- Prezantimi i videove (gjidhënia, ushtrimet, joga, duhanpirja etj)

Pas sesionit pjesëmarrësve ju dhurohet vitaminat prenatale të ofruara nga Action for Mother and Children, dhe broushra educative.

RRITJA E CILËSISË

- Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga Ministria e Shëndetësisë, Action for Mother and Children, Unicef apo cdo organizatë tjeter që fton për pjesëmarrje në trajnimet që kanë të bëjnë me rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, planifikimin familjar dhe shtatëzanin, lehonin etj.
- Propozim që infermierëve e trajnuara për KN gjatë orarit të punës të ju caktohet një periudhë kohore për të lexuar për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, planifikimin familjar dhe shtatëzanin, lehonin etj. në ëebaqe kredibile mjekësore.

RRITJA E NUMRIT TË PJESËMARRËSVE NË KLASËN PËR NËNA

- Infermieret e trajnuara brenda orarit të punës të organizojnë sesione
- Shpërndarja e listët në Qendra të Mjekësisë Familjare dhe ne Ambullanta të Mjekësisë familjare për rekrutimin e femrave që planifikojnë shtatëzani, shtatzëna, lehonave dhe cifteve të identikuara që kanë nevojë për këshilla rreth planifikimit familjar.
- Bashkëpunimi kolegia për të sjell pjesëmarrës në sesionet e KN

PROMOVIMI I KLASAVE PËR NËNA

- Promovimi i programit në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor
- Promovimi i programit në rrjete sociale (facebook)
- Promovimi i programit në radion e qytetit dhe sipas mundësisë në emisionet televizive
- Bashkëpunimi me QMF-të, AMF-të për informimin e vajzave, grave dhe cifteve për këtë programit dhe mundësit që ofron
- Planifikohen postier informues për këtë program në QKMF, QMF, AMF në komunën e Vushtrrisë
- Planifikohen fushata informuese në qytet dhe në fshatra për ekzistimin e këtij programi (në bashkëpunim me kuvendin komunal, drejtorinë e shëndëtësisë , të arsimit, të kulturës, me këshillin e fshatrave dhe me organizatat joqeveritare)

PLANI I PUNËS NË KUADËR TË KLASËS PËR NËNA

Tabela 1. Pritshmëritë për vitin 2025 në KN

AKTIVITETI	BARTËSITË E AKTIVITETEVE	ORGANIZIMI I PUNËS DHE RAPORTIMI	PLANIFIKIMI I REALIZIMIT	LOKACIONI
Edukimi dhe informimi për shëndetin e nënës dhe fëmijës	Infermierët e trajnuar për KN	Koordinatoja e KN	Janar- Dhejtor 2025	Dhoma për edukim dhe promovim shëndetësor

PRITET QË GJATË VITIT 2025 NUMËRI I PJESËMARRËSVE NË KLASA TË ARRIJ NË: 300

Programi “Kujdesi në Grup në 1000 ditët e para” në komunën e Vushtrrisë funksionon nga muaji mars 2023, deri më tanjjanë krijuar 4 grupe me shtatzëna, aktualisht është duke u punuar për rekrutimin e grave shtatzëna për grupin e pestë.

MËNYRA E FUNKSIONIT TË KUJDESIT NË GRUP PËR GRATË SHTATZËNA

Ky program përmban dhjetë sesione, cdo session ka tema të ndryshme, sesioni organizohet 1 herë 2-3 javë. Gratë shtatzëna duhet të jenë në periudhën 12-20 javë të shtatëzanisë për t'u rekrutuar në grup për sesionin e parë. Një session zgjatë 2 orë, për secilin session fasilitoret janë të obliguara të bëjnë një plan, të dokumentojnë planin dhe të raportojnë për të.

Të gjitha sesionet janë të organizuara në atë mënyrë që shtatzënati shprehin mednimet lirshëm, nën përcjellen e infermierëve.

Pika kyqe ështe që infermieret që fillojnë atë grup, po ato infermieri duhet ta përfundojnë me sesionin e fundit me fëmijë (pra pas lindjes)

RRITJA E CILËSISË SË KUJDESIT NË GRUP PËR GRATË SHTATZËNA

- Përgatitja paraprake për secilin sesion nga infermieret e trajnuara
- Përfshirja e mjekëve te mjekësisë familajre, specialistëve si gjinekolog, pediatër ne sesionet ku parashihet pjesëmarra e tyre
- Bashkëpunimi në mes dy fasilitatorëve (infermierëve që organizojnë sesionet)
- Vazhdimi i bashkëpunimit me Action for Mother and Children
- Vazhdimi i bashkëpunimit me Unicefin

RRITJA E NUMRIT TË GRUPEVE TË FORMUARA

- Vizitë cdo ditë nga infermierët në ambullaten e gjinekologjisë pranë spitalit “Shekya Zayed” në Vushtrri për rekrutimin e grave shtatzëna dhe shikimi I mundësisë për bashkëpunim më të gjerë me repartin e Gjinekologjisë në të mirën e këtij programi
- Shfrytëzimi i shërbimit të “Vizitave në shtëpi për nëna dhë fëmijë 0-3 vjec” për rekrutimin e shtatzënave
- Shfrytëzimi i shërbimit “Klasa për Nëna” për rekrutimin e shtatzënave
- Shpërndarja e listave përrregjistrimin e shtatzënave nëpër të gjitha institucionet e kujdesit parësor shëndetësor
- Krijimi i bashkëpunimit me Spitalin e Mitrovicës “Dr. Sami Haxhibeqiri”, konkretisht me departamentin e gjinekologjisë për identifikimin e shtatzënave nga Vushtrria

PROMOVIMI I KUJDESIT NË GRUP ME SHTATZËNAT

- Shpërndarja e fletushkave/posterave informuese për programin “Kujdeis në grup me shtatzënat”
- Promovimi i programit nëpërmjet radios së qytetit
- Pjesëmarra e koordinatores dhe infermierëve që organizojnë sesione në emisione televizive

- Vazhdimesia e postimeve në rrjete sociale për sionet e organizuara

PLANI PËR PUNËN NË KUADËR TË KUJDESIT NË GRUP PËR GRATË SHTATZËNA

Tabela 1. Tabela 1. Pritshmëritë për vitin 2025 në Kujdesin në Grup për Shtatzëna

AKTIVITETI	BARTËSITË E AKTIVITETEVE	ORGANIZIMI I PUNËS DHE RAPORTIMI	PLANIFIKIMI REALIZIMIT	LOKACIONI
Edukimi dhe informimi për shëndetin e shtatzënës	Infermierët e trajnuar për kujdes në grup për shtatzëna	Koordinatoja e KN	Janar- Dhejtor 2025	Dhoma për edukim dhe promovim shëndetësor
PRITET QË GJATË VITIT 2025 NUMËRI I GRUPEVE TË FORMUARA TË ARRIJ NË: 4 GRUPE				

Kujdesi në Grup për Prindërim është program edukativ dhe promovues I shëndetit, zhvillohet me anë të sesioneve grupore me prindër, e temat të cilat I mbulon janë të tillë si prindërimi pozitiv, zhvillimi I fëmijëve, kujdesi prenatal dhe postnatal, rritja dhe zhvillimi I fëmijëvë, gjidheniëa, vakinimi, siguria në ambientin ku qëndron fëmija etj.

MËNYRA E FUNKSIONIMI TË KUJDESIT NË GRUP PËR PRINDËRIM

Kujdesi në grup për prindërim ka për qëllim edukimin e prindërve, me anë të sesioneve educative. Gjithësej janë 7 sesione, prindërit së bashku me fëmijët marrin pjesë në sesione. Mosha e fëmijëve për sesionin 1 është 1-2 muaj, mosha e fëmijëve për sesionin 2 është 3-4 muaj, mosha e fëmijëve për sesionin 3 është 5-6 muaj, mosha e fëmijëve për sesionin 4 është 7-8 muaj, mosha e fëmijëve për sesionin 5 është 9-11 muaj, mosha e fëmijëve për sesionin e 6 është 12-14 muaj, mosha e fëmijëve për sesionin e 7 është 15-17 muaj.

Në cdo session matet pasha, perimetri dhe gjatësia e fëmijës, ndërsa për nënën pasha trupore dhe presioni arterial.

RRITJA E CILËSISË NË KUJDESIN NË GRUP PËR PRINDËRIM

- Përgatitja paraprake për secilin session nga infermieret e trajnuara
- Bashkëpunimi në mes të dy fasilitaorëve (infermierëve)
- Përgatitja e planit për secilin session nga infermierët
- Vazhdimi I bashkëpunimit me Action for Mother and Children

- Vazhdimi I bashkëpunimit me Unicefin

RRITJA E NUMRIT TË GRUPEVE TË FORMUARA

- Shfrytëzimi i shërbimit “Klasa për Nëna” për rekrutimin e nënave dhe baballarëve
- Shpërndarja e listave përregjistrimin e prindërve nëpër të gjitha institucionet e kujdesit parësor shëndetësor
- Shfrytëzimi i shërbimit “Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0-3 vjec” për rekrutimin e prindërve
- Shfrytëzimi i shërbimit të “Vaksinimit” për rekrutimin e prindërve

PROMOVIMI I KUJDESIT NË GRUP ME SHTATZËNAT

- Shpërndarja e fletushkave/posterave informuese për programin “Kujdesi në Grup për Prindërim”
- Promovimi i programit nëpërmjet radios së qytetit
- Pjesëmimarja e koordinatores dhe infermierëve që organizojnë sesione në emisione televizive
- Vazhdimësia e postimeve në rrjete sociale për sesionet e organizuara

PLANI PËR PUNËN NË KUADËR TË KUJDESIT NË GRUP PËR PRINDËRIM

Tabela1. Pritshmëritë për vitin 2025 në Kujdesin në Grup për Prindërim

AKTIVITETI	BARTËSITË E AKTIVITETEVE	ORGANIZIMI I PUNËS DHE RAPORTIMI	PLANIFIKIMI I REALIZIMIT	LOKACIONI
Edukimi dhe informimi I prindërve	Infermierët e trajnuar për kujdes në grup për prindërim	Koordinatoja e KN	Janar- Dhejtor 2025	Dhoma për edukim dhe promovim shëndetësor
PRITET QË GJATË VITIT 2025 NUMËRI I GRUPEVE TË FORMUARA TË ARRIJ NË: 8 GRUPE DHE VAZHDIMËSIA E SESIONEVE PËR DY GRUPET E FORMUARA				

Shërbimi i kujdesit shtëpiak për nëna dhe fëmijë 0-3 vjec mundëson kontaktin e drejtëpërdrejt me familjen, gjatë vizitës në shtëpi përvcq kujdesit të vecantë për nënën dhe fëmijën analizohen edhe qeshtje të tjera si psh: marrëdhëniet nënë-baba, marrëdhëniet prinder-fëmijë, siguria në shtëpi etj.

Shërbimi i VSH është shërbimin në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe funksionin e vet e ushtron duke u bazuar në: LIGJI Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI.

MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË VIZITAVE SHTËPIAKE PËR NËNA DHE FËMIJË 0-3 VJEC

Shërbimi i VSH ka për qëllim të realizoj vizitat shtëpiake për shtatzëna dhe fëmijët 0-3 vjec.

Vizitat te shtatzënat:

Janë të planifikuara dy vizita gjatë periudhës së shtatzanisë (vizita e parë gjatë tremujorit të parë tek i dyti, vizita e dytë nga tremujori i dytë deri tek i treti)

Vizitat te fëmijët dhe lehonat:

Janë të planifikuara 5 vizita në shtëpi për fëmijët 0-3 vjec në këtë interval moshe sin ë vijim:

- Vizita e parë (në ditët e para paslindjes, këtu përfshihet edhe vizita për lehonën)
- Vizita e dytë në moshën 4-6 muaj
- Vizita e tretë në moshën 11-12 muaj
- Vizita e katertë në moshën 18 muaj
- Vizita e pestë në moshën 36 muaj

Për te dy kategoritë ekziston edhe vizita shtesë në rastet kur vlerësohet që kanë nevojë për më shumë se dy vizita gratë shtatzëna dhe më shumë se 5 vizita te fëmijët sipas planifikimeve!

Janë tre faktorë të rëndësishëm që duhet të ju kushtohet vëmendje për suksesin e këtij shërbimi. Ekzekutimi në praktikë i këtyre faktorëve në vitin 2025 është një sfidë në vete, mirëpo është bërë planifikimi për mënyren e realizimit.

Faktoret e rëndësishëm për shërbimin e VSH janë:

- Rritja e cilësisë së vizitave në shtëpi
- Rritja e numrit të vizitave shtëpiake
- Promovimi i shërbimit të vizitave shtëpiake

RRITJA E CILËSISË

Kryerja e vizitave shtëpiake është shërbim mjaft me përgjegjësi, andaj është shumë e nevojshme që vizitat të jenë cilësore, kjo planifikohet të arrihet përmes këtyre pikave:

- Gjatë vizitës në shtëpi aplikimi i instrumentit ndërkombetar për monitorim të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve “GMCD”
- Vazhdimësia e referimit të fëmijëve që kanë ngecje në rritje dhe zhvillim te mjeku familjar
- Vazhdimësia i bashkëpunimit me mjek të mjekësisë familajre për trajitim të fëmijëve me ngecje në zhvillim.
- Në bashkëpunim me zyrën e financave në QKMF është planifikuar blerja e lodrave për fëmijë, lodra të nevojshme gjatë vizitave në shtëpi për të parë zhvillimin social, emocinal, kognitiv, fizik dhe psikologjik të fëmijës.
- Përditësimi i njohurive të stafit (një infermiere e caktuar që të ndjek më të rejat e fundit në fushën e zhvillimit të fëmijëve dhe shtatëzanisë nga organizatat kredibile ndërkombebare e kombëtare mjekësore)
- Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga Ministria e Shëndetësisë, Action for Mother and Children, Unicef apo cdo organizatë tjeter që fton për pjesëmarrje në trajnimet që kanë të bëjnë me rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, planifikimin familjar dhe shtatëzanin.
- Përfshirja si temë e veqantë “Vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0-3 vjec” gjatë trajnimeve të shkurtëra që organizohen në kuandër të QKMF
- Propozim që infermierëve gjatë orarit të punës të ju caktohet një periudhë kohore për të lexuar për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, në ëebfaqe kredibile mjekësore.
- Bashkëpunimin ndërinstitucional

RRITJA E NUMRIT TË VIZITAVE TË OFRUARA NË SHTËPI

Planifikohet të arrihet si në vijim:

- Sfidë mungesa e personelit të angazhuar për vizita në shtëpi
- Takim me menaxhmentin për përkrahjen e koordinatores për riorganizimin të vizitave shtëpiake me qëllim gjithëpërfshirajes së fëmijëve dhe shtatzënave.
- Vizitë QMF-ve dhe AMF-ve në komunën e Vushtrrisë për planin dhe riorganizimin e programit
- Riaktivizimi i infermiereve në QMF dhe AMF për kryerjen e vizitave në shtëpi
- Aplikimi i databazës në punën e përditshme me qëllim të elemiimit të mundësisë që fëmijët apo shtatzënati vizitohen më shpesh se sa që është e paraparë me standardin e MSH
- Evidencimi i prindërve të cilët orarin e vizitave në shtëpi nuk e kanë të përshtatshëm (organizimi i këtyre vizitave në orar të përshtatshëm për prindërit)
- Vizita e të posalindurëve në tri ditët e para
- Vizita e dytë për fëmijët e moshës 4-6 muaj
- Vizita e III për fëmijët e moshës 11-12 muaj
- Vizita e IV për fëmijët e moshës 18 muaj

- Vizita e V për fëmijët e moshës 36 muaj

PROMOVIMI I VIZITAVE SHTËPIAKE

Planifikohet të arrihet si në vijim:

- Shpërndarja e fletushkave/posterave informuese për programin “Vizitat në shtëpi” nëpër lagje, shkolla, fshatra etj.
- Promovimi i programit nëpërmjet radios së qytetit
- Pjesëmarrja e koordinatores dhe infermierëve që kryejnë vizita në shtëpi në emisione televizive
- Vazhdimësia e postimeve në rrjetet sociale të vizitave të kryera në teren
- Vazhdimësia e postimeve në rrjetet sociale lidhur me rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, prindërimin, gjidhënien, vaksinimin etj

CKA SYNOHET TË ARRIHET GJATË VITIT 2025 NË VIZITAT SHTËPIAKE PËR SHTATZËNAT/FËMIJËT

1. Edukimi shëndetësor i nënave dhe baballarëve për prindërimin
2. Këshillimi i shtatzënave për një shtatzani të shëndetshme
3. Këshillimi i ciftit për planifikim familjar
4. Këshillimi i prindërve për ndikimin e tyre në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës
5. Këshillimi për gjumin e fëmijës (rutinen e gjumit)
6. Këshillimi për sigurin në shtëpi
7. Promovimi i ushqyerjes ekskluzive me gji në gjashtë e muajt e parë të jetës të fëmijës
8. Raportimi i rasteve të indetifikuara për dhunë në familje
9. Referimi i shtatzënave te mjeku në rast nevoje
10. Referimi i fëmijëve te mjeku në rastet e ngecjes në zhvillim në cilën do fushë që ngecin
11. Bashkëpunimin ndërinstitucional
12. Identifikimi i fëmijëve të pavaksinuar sipas kalendarit zyrtar të Republikës së Kosovës
13. Vetëdijësimi i prindërve për rëndësin e përbushjes së kalendarit të vaksinimit për fëmijët e tyre

PLANI PËR PUNËN NË TERREN

Tabela 1. Të dhënat e përgjithshme

AKTIVITETI	BARTËSIT E AKTIVITETEVE	ORGANIZIMI I PUNËS DHE RAPORTIMI I VIZITAVE	PLANIFIKIMI I REALIZIMIT	LOKACIONI
------------	-------------------------	---	--------------------------	-----------

Vizita në shtëpi	Infermierët e vizitave shtëpiake	Koordinatorja e VSH	Janar- Dhjetor 2025	Qyteti dhe fshatrat
------------------	----------------------------------	---------------------	---------------------	---------------------

Targetin për cdo vit, për secilin komunë e percakton Ministria e Shëndetësisë. Një vizitë zgjatë 45 min

- *Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiak sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.*
- Bazuar në marrëveshjen mes Komunës së Vushtrrisë dhe IRW Kosova, si organ mbikëqyrës, andaj sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Worldwide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit:
- Projekti është realizuar sipas Objektivave të shtojcës B të marrëveshjes për ofrimin dhe dhënien e shërbimeve mjekësore si :
 - Gratë shtatzëna dhe lehonat;
 - Moshë e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
 - Personat me aftësi të ndryshme;
 - Personat me sëmundje kronike;
 - Pesonat me sëmundje malinje;

Për ofrimin e shërbimeve mjekësore do të furnizohemi sipas kërkesës:

1. Furnizimi me barëra dhe material shpenzues mjekësore;
2. Furnizimi me karburant për vetura, servisimi dhe mirëmbajtja e veturave;
3. Furnizimi me mbushje të telefonisë mobile;

Sektori i Shëndetit Oral Preventiv

Në sektorin e shëndetit oral preventiv vizitohen të gjithë qytetarët pa dallim etnie, kombi. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllombimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë.

Shërbimet në sektorin e shëndetit oral preventive:

Shërbimet për nxjerrjen e dhëmbit: Caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, eks. Dhëmbit, tamponade e alveolës, këshilla për pacientin.

Shërbimet për vizita: caktimi i diagnozës, aplikim local me udhëzim për rtg dhe terapia e përgjithshme.

Shërbimet për shërimin e karriesit: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit, vendosja e shtresës (me ose pa kalcimol), vendosja e bllombës dhe polirimi dhe korigjimi i pikave kontaktuese.

Shërbimet te pulpitet e dhëmbëve: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit deri në hyrje të kanaleve, eksterpimi i pulpës, mbushja e kanalit dhe vendosja e bllombës.

Shërbimet te gjakderdhja pas nxerrjes së dhëmbit: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, kiretazha e alveolës, vendosja e hemostatikut dhe tamponade e alveolës.

Trajtimi i gingiviteve: largimi I pigmenteve të buta dhe të forta me kavitron dhe past me brush.

Bazuar në statistikat sipas regjistrat të popullësise të vitiit 2011 në ASK komuna e Vushtrrise ka gjithësej 69870 banor, KPSH në Vushtrri ka gjithësejt 9 stomatolog, sipas U/A 6000 banor për një stomatolog, andaj nevoja është për rritjen e numrit të stomatologëve, duke ja shtuar dhe hapjen e shërbimit stomatologjikë ne Pantinë dhe Lumadh.

Kemi financuar dy stomatolog për kryerjen e specializimit në fushën e Pedodoncisë preventive.

Shërbimi i Urgjencës

Në Urgjencë shërbimet janë 24^h dhe punohet cdo ditë të javës. Në këtë shërbim janë të angazhuar katër ekipe që punojnë me ndërrime 12 orësh, këtu kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita. Urgjencia transporton pacientet nga vendi i ngjarjes deri në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri e nëse kërkohet ndihmë nga Emergjencia e spitalit, transportoën pacientët sipas nevojës në SHSKUK Prishtinë. Në disa raste ofrojn vizita dhe shërbime shëndetësore edhe në shtëpi, kur gjendja e pacientit është e rënd.

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

Laboratori se bashku me Rëntgenin bëjnë pjesë në sektorin e diagnostikës.

- Sektori i Laboratorit

Do të vazhdohet të punohet sipas planprogramit të paraparë me U/A për Kujdesin Parësor Shëndetësor.

Gjatë vitit 2025 do të hapet laboratori në QKMF dhe do të funksionalizohen gjithësejt katër laboratorë: QKMF, QMF-1, QMF-3 dhe QMF Lumadhi.

Kemi financuar dy specialista të Biokimisë Klinike të cilët pas specializimit do të funksionojnë në QKMF.

Do të punohet në kujdestari për rastet urgjente.

- Sektori i Rentgenit

Do të vazhdohet të punohet sipas planprogramit të paraparë me U/A për Kujdesin Parësor Shëndetësor.

Gjatë vitit 2025 do të hapet bëhet ndërtimi i rëntgenit .

Kemi financuar një specialist të Radiologjisë i cili pas specializimit do të funksionojnë në QKMF.

Do të punohet edhe pasdite për rastet urgjente.

Planifikojmë të pajisemi me Mamograf me bashkëfinancim Komuna Vushtrri dhe Islamic Relief me seli në Prishtinë

Barnatorja Qendrore

Ka për detyrë të bënë planifikimin, organizimin, ruajtjen e zingjirit të ftohtë dhe liferimin e produkteve medicinale nëpër QMF dhe AMF.

Nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë është planifikimi për vitin 2025.

Depoja Qendrore Farmaceutike gjatë vitit 2025 do të bënë shpërndarjen e barnave dhe materialit shpenzues në gjithsej 18 QMF dhe AMF të komunës së Vushtrrisë, ne interval te caktuara kohore, QMF dhe AMF për çdo muaj, ndërsa QKMF dhe QMF-1 në intervale 2 javore.

EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL MJEK – INFERMIER

EVP PËR MJEK

Bazuar në Strategjinë e Shëndetësisë së Kosovës, Strategjinë e KPSH, Udhëzimin Administrativ për Zhvillimin e Vashdueshëm Profesional e me qëllim të edukimit të vazhdueshëm dhe ngritjes së vazhdueshme profesionale të profesionistëve shëndetësor si dhe me qëllim të përbushjes së obligimeve që dalin nga politikat shëndetësore për KPSH në Kosovë e që kanë të bëjnë me ZHVP, Komiteti për ZHVP i QKMF-së do të planifikoj dhe organizoj aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm professional, aktivitete këto të cilat do të janë në përputhje me kornizën e aktiviteteve të ZHVP të QZHMF të Kosovës si dhe me nevojat e profesionistëve shëndetësor të QKMF të Vushtri-s

ZHVP- në kuadër te QKMF në Vushtri do të zhvillohet në bashkëpunim me QZHMF në Prishtinë dhe QTMF në Mitrovicë. E tërë kjo do të menagjohet nga kryetari I komitetit për ZHVP si bartës kryesor dhe dy antaret e komitetit përgjegjës për ZHVP të stafit infirmierik. Do të organizohen aktivitete të ndryshme në kuadër të ZHVP në formë:

- Ligjératave mujore
- Auditeve
- Rishqyrtimëve kolegiale dhe trajnimeve
- Ligjérues do të janë mjekët familjarë por nëse do të arrihet mirëkuptim dhe marrëveshje, do të bashkëpunohet edhe me mjek te specializimeve të tjera.

Nr.	Orari	Tema	Ligjéruesi	Vendi	Pjesëmarrës
1.	28.01.2025 13:00 – 15:00	Infekzionet me te shpeshta te traktit te siperm respirator	Dr. A.Z	QKMF Vushtri	31 pjesëmarrës (mjeke familjare dhe doktor te mjekësisë)
2.	27.02.2025 13:00 – 15:00	Planifikimi Familjare	Dr.F.M	QKMF Vushtri	31 pjesëmarrës (mjeke familjare)
3.	26.03.2025 13:00 – 15:00	Gastritet	Dr.B.A	QKMF Vushtri	31 pjesëmarrës (mjeke familjare)
4.	28.04.2025 13:00 – 15:00	Çrregullimet e stresit postraumatik	Dr. U.H	QKMF Vushtri	31 pjesëmarrës (mjeke familjare)
5.	28.05.2025 13:00 – 15:00	Diabeti Melittus	Dr.M.B	QKMF Vushtri	31 pjesemarres (mjeke familjare)
6.	27.06.2025 13:00 – 15:00	Infekzionet e traktit urinar	Dr.F.H	QKMF Vushtri	31 pjesemarres (mjeke familjare)
7.	27.09.2025 13:00 – 15:00	Konvulzionet febrile	Dr.A.K	QKMF Vushtri	31 pjesemarres (mjeke familjare)

8.	28.10.2025 13:00 – 15:00	Dhimbjet akute te abdomenit	Dr.F.Z	QKMF Vushtri	31 pjesemarres (mjeke familjare)
9.	27.11.2025 13:00 – 15:00	Hiper dhe Hipotireozat	Dr.B.S	QKMF Vushtri	31 pjesemarres (mjeke familjare)
10.	27.12.2025 13:00 -15:00	Menaxhimi i krizave hipertenzive	Dr.B.K	QKMF Vushtri	31 pjesemarres (mjeke familjare)

Ligjëratat do të bazohen në nevojat e participanteve, temat do të caktohen paraprakisht dhe ato do të kenë përbajtje jo vetëm klinike por edhe të qeverisjes klinike dhe menaxheriale. Do të hulumtohet pë të krijuar mundësi për implementimin eventual të pilotprojekteve të ndryshme të cilat do të ishin në interes për QKMF dhe atë në bashkëpunim me QZHMF dhe QEVI.

Te gjitha aktivitetet do te organizohen dhe mbahen gjate gjithë vitit përvèç muajve korrik dhe gusht për shkak te pushimeve vjetore.

Natyrisht me është konfirmuar nga Komisioni për Edukim te vazhdueshëm Profesional pranë Odes se Mjekeve qe nga ky plan secila ligjëratë do te akrediohet me 4 pike për pjesëmarrësit aktivë dhe 3 pike për pjesëmarrësit pasive.

Orari i aktiviteteve do ti bashkëngjitet këtij plani ne shtojcen nr 1.

Periudha e trajnimit: Janar-Dhjetor 2025 EVP INFERMIEROR

Kursi i ngritis profesionale është procesi me të cilin infermierët vazhdojnë të mësojnë, zhvillojnë dhe ruajnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar kujdes të sigurt dhe efektiv për pacientët e tyre.

Infermieret e Kujdesit Parësor Shëndetësor paraqesin një aspekt te profesionit te infermierisë qe përqendrohet ne ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientet e KPSH.

Qëllimi: i këtij trajnimi është që profesionistet shëndetësor të pajisen me njohuri shtesë me temat qe do te ligjerohen gjate viti 2025. Temat do te jene ne përputhshmëri me problemet aktuale dhe kërkesat e pjesëmarrësve në trajnimet paraprake.

Metodologjia: Në trajnim do të përfshihen 7-10 pjesëmarrës, brenda dite janë planifikuar të mbahen nga 2 tema për 5 ditë pune. Gjatë kësaj periudhe do të përfshihen të gjithë profesionistët shëndetësor.

Zbatimi i programit

Programi është obligativ për të gjithë profesionistët shëndetësor të QKMF-së, QMF-së dhe AMF-së.

Përbajtja e programit ka dhjetë tema:

1. Mbingarkesa në punë dhe menagjimi

2. Lëndimet më të zakonshme të infermierët gjatë punës
3. Vleresimi i nevojave për kujdes te personat geriatrik
4. Strategjitet e menaxhimit të dhimbjes
5. Kequshqyeshmëria, simptomet, trajtimi/Kujdesi infermieror
6. Anemia simptomet, llojet dhe shkaktarët
7. Përdorimi dhe administrimi i sigurt i medikamenteve në praktikat infermierore
8. Kujdesi infermieror për pacientët me alergji dhe reaksionet alergjike
9. Përdorimi defibrilatorit automatik - AED
